



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TDS SH.P.K
Numri unik identifikues 811348251
Pronar: AM Invest Group SH.P.K dhe J&P PRO SH.P.K.
Person i autorizuar: Valon SHALA
Operatori i Shpërndarjes "TDS SHPK"
Platforma Satelitore
Zona Industriale (ish Fabrika e Amortizatorëve)



VE N D I M

për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes TDS SHPK, platforma Satelitore – me seli në
Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01) përcakton rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, pavarësisht nga teknologjia e përdorur.
3. Më datën 1 nëntor 2019, kandidati "TDS SHPK" ka parashtruar kërkesë për licencë të KPM-së për të vepruar si Operator i Shpërndarjes, përmes platformës Satelitore.

Arsyetim

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të

frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

1. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
2. Komisioni konstaton se kandidatit për licencë për operator të shpërndarjes “TDS SHPK” i janë ofruar të gjitha aktet nënligjore për aplikim për licencë si: Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01), Rregullore për Tarifën Vjetore për Licencë (2) (KPM-2017/06), dhe Formën për aplikim për licencë të KPM-së, për operator të shpërndarjes.
3. Komisioni vlerëson se kandidati “TDS SHPK” ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator të shpërndarjes në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullores KPM-2016/01 dhe të shtojcës së kësaj rregullore, ku përcaktohen Procedurat, Kushtet dhe Kriteret për Licencim.
4. Me Rregulloren KPM-2016/01 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator të shpërndarjes. Prandaj, Komisioni e KPM-se vlerëson se, një operator i shpërndarjes mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01, ndërsa, kandidati “TDS SHPK” ka dorëzuar një listë prej 50 kanaleve, si pjesë e katalogut programor.
5. Kandidati “TDS SHPK” për operator të shpërndarjes sipas platformës Satelitore, përveç ofruesve të shërbimeve programore të licencuara nga KPM, të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01, do të ketë të drejtë të bartë në katalogun e tij programor vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit.
6. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator të shpërndarjes “TDS SHPK” mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në platformën Satelitore, dhe mund të zgjerojë katalogun e programeve në të ardhmen. Kandidati “TDS SHPK” obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t’i ketë siguruar ato.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati “TDS SHPK” ka dorëzuar aplikacionin e tij në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren KPM-2016/01 si dhe me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/06, për t’u pajisur me licencë të KPM-së për një afat prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi të ripërtëritjes.
8. Komisioni vlerëson se, kandidati për operator kabllor “TDS SHPK” ka përmbushur kriteret për kualifikim për t’u pajisur me licencë të KPM-së.

Vendim

9. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 28 shkurt 2020 merr vendim që, kandidatit “TDS SHPK” me seli në Pejë, t’i lëshojë licencën e KPM-së për operator të shpërndarjes sipas platformës SATELITORE, për të ofruar shërbime të programeve në pajtim me katalogun e ofruar programor sipas marrëveshjeve për të drejtat autoriale të atyre shërbimeve mediale audiovizuale, për të operuar në Republikën e Kosovës.

10. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



02.03.2020
datë